

Reg. V. 1760/2000 (EC)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE
MBROJTJES SE KONSUMATORIT
MINISTRI

Nr. 980 Prot.

Tirane, me 17/2/2010

UDHËZIM

Nr. 2 Datë 17/2/2010

MBI

SISTEMIN E ETIKETIMIT TË MISHIT TË GJEDHIT DHE PRODUKTEVE TË
TIJ

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9863, datë 28.1.2008 "Per Ushqimin", nenin 95 te ligjit 9590 date 27.07.2006 " Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European dhe shteteve të tyre anëtare", V.K.M. Nr. 463 datë 05.07.2006 " Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit" i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim të zbatohet për etiketimin e mishit të gjedhit dhe produkteve të tij të paketuara.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- "Mish gjedhi.", është produkti që origjinton nga kafshët e species gjedh.

- "Etiketimi". është çdo fjalë, pamje, markë tregtare, emër tregtar, konfigurim apo simbol për një ushqim, që vendoset mbi çdo paketim, dokument, njoftim, etiketë, unazë ose mbajtëse, që bashkëngjitet një cope individuale ose copave të mishit ose në materialin e tyre të paketimit, shkruar në formë të dukshme për konsumatorin në pikat e shitjes.

3. Kërkesat për operatorët e biznesit ushqimor për etiketimin e mishit të gjedhit dhe produkteve të tij të paketuara për tregun e brendshëm janë si më poshtë:

a. Cdo operator i biznesit ushqimor të etiketojë mishin e gjedhit dhe produktet e paketuara të mishit të gjedhit në të gjitha fazat e tregtimit të tij me shumicë dhe pakicë.

b. Etiketimi i mishit të gjedhit dhe produkteve të tij bëhet në bazë të VKM Nr.1344, dt 10.10.2008 " Per etiketimin e produkteve ushqimore".

c. Etiketa e mishit të gjedhit dhe produkteve të tij të paketuara që origjinon nga mish i importuar dhe që tregtohet në tregun e brendshëm të përmbajë edhe informacionin bazë të etiketës origjinale.

4. Kërkesat për Operatorët e Biznesit Ushqimor për etiketimin e mishit të gjedhit dhe produkteve të tij të paketuara për eksport për në vendet e BE-së janë si më poshtë:

a. Etiketimi të sigurojë një lidhje midis identifikimit të karkasës, çerekut ose copave të mishit nga njëra anë dhe nga ana tjetër, numrit individual të kafshës ose, kur kjo është e mjaftueshme që të mundësojë saktësinë e informacionit në etiketë për të kontrolluar grupin e kafshëve në fjalë që ka lidhje me të.

b. Etiketa duhet të përmbajë të dhënat në vijim:

(i) një numër reference ose kodin e referencës duke siguruar lidhjen midis mishit dhe kafshës ose kafshëve. Ky numër mund të jetë numri i identifikimit individual të kafshës nga i cili origjinon mishin i gjedhit ose numri i identifikimit në lidhje me një grup kafshësh;

(ii) numrin e miratimit të thertores në të cilën kafsha ose grupi i kafshëve është therrur dhe shtetin, vendin në të cilën kjo thertore është ngritur. Në tregues të lexohet: "Therrur në" (emri i shtetit, rajonit) (numërin e miratimit);

(iii) numërin e miratimit të stabilimentit të prerjes në të cilën kryhen operacionet e prerjes së karkasës ose grupit të karkasave, si dhe emri i Shtetit, rajonit në të cilën është ngritur ky stabiliment. Në tregues të lexohet: "Prere në: (emri i shtetit, rajonit) (numri miratimit)".

c. Megjithatë, kur detaje të mjaftueshme janë në dispozicion të identifikimit dhe sistemit të rregjistrimit të kafshëve të gjedhit, përveç sa është parashikuar më lart, mund që, për mishin që origjinon nga kafshët të lindura, rritura dhe që theren në të njëjtën vend, ky informacion shtesë të shenohet gjithashtu në etiketë si më poshtë:

(i) Shtetin ose rajonin e lindjes;

(ii) Shtetin ose rajonin, ku u bë therrja;

d. Shmangiet nga kërkesat e mesiperme të etiketimit të bëhen si më poshtë:

Një operator i biznesit ushqimor për përgatitjen e mishit të gjedhit të grirë të tregojë në etiketë fjalët "Përgatitur (emrin e shtetit dhe rajonit)", në varësi ku mishin është përgatitur, dhe "origjinën" kur shteti ose shtetet nuk janë përfshirë në shtetin e përgatitjes. Megjithatë, një operator i biznesit ushqimor mund të shtojë në etiketë e mishit të gjedhit të grirë:

- një ose më shumë shenja të parashikuara në rregullat e lartpërmendura dhe / ose

- datën në të cilën mishin është përgatitur.

5. Etiketimi i mishit të gjedhit dhe produkteve të tij të importuara nga vendet e treta.

Mishi i gjedhit importuar nga vendet e treta për të cilin jo i gjithë informacioni i parashikuar më lart është i vlefshëm, të etiketohet me treguesit:

'Origjina: jo-BE' dhe 'Therrur në: (emri i vendit të tretë).'

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

